



Republika e Kosoves
Republika Kosovo/ Republic of Kosovo
Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tuzilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council

KPK.Nr. 379/2023
Datë: 23 maj 2023

Këshilli Prokurorial i Kosovës, duke vendosur në çështjen disiplinore ndaj Ervehe Gashi, prokurore në Prokurorinë Themelore në Prizren, në pajtim me nenin 34 të Ligjit Nr. 06/L - 056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, nenit 13 të Ligjit Nr. 06/L - 057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, sipas marrëveshjes vullnetare për shkeljen e supozuar disiplinore me numër AD.nr.03/2023, të datës 28 prill 2023, gjatë shqyrtimit të mbajtur më datë 23 maj 2023, në seancën e këshillimit dhe votimit morri këtë:

VENDIM

- I. **MIRATOHET** marrëveshja vullnetare për shkeljen disiplinore me numër AD.nr.03/2023, të datës 28 prill 2023, e lidhur në mes Panelit Hetimor dhe subjektit të hetimit disiplinor Ervehe Gashi, prokurore në Prokurorinë Themelore në Prizren.
- II. Prokurores Ervehe Gashi i shqiptohet sanksioni disiplinor "Vërejtje publike me shkrim" konform nenit 7, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L - 057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.
- III. Marrëveshja vullnetare për shkeljen disiplinore dhe sanksionin disiplinor e miratuar nga paneli hetimor do të ketë të njëjtin efekt ligjor sikurse vendimi i Këshillit për shkelje disiplinore, konform nenit 13 të Ligjit Nr.06/L - 057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

ARSYETIM

Më datë 07 mars 2023, Këshilli Prokurorial i Kosovës, nga autoriteti kompetent, Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Prizren, ka pranuar kërkesën për fillimin e hetimit disiplinor ndaj Ervehe Gashi, prokurore në Prokurorinë Themelore në Prizren - Departamenti i Krimeve të Rënda, në mbështetje të nenit 12, paragrafi 2 të Ligjit Nr. 06/L - 057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Autoriteti kompetent i ka rekomanduar Këshillit Prokurorial i Kosovës, që prokurores Ervehe Gashi të i shqiptohet sanksioni disiplinor "Vërejtje publike me shkrim" në përputhje me nenin 7, paragrafi 1, pika 1.2 të Ligjit të lartcekur, lidhur me lëshimin e veprimeve procedurale, ku në rastin konkret prokurorja Ervehe Gashi, ka ngritur aktakuzën [REDAKTUAR] /2019, jashtë afatit ligjor, ndaj zyrtarëve të lartë të Komunës së Prizrenit lidhur me veprën penale "Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar" nga neni 422, paragrafi 2, pika 2.1 dhe 2.2 lidhur me paragrafin 1, neni 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Më datë 23 mars 2023, Këshilli Prokurorial i Kosovës, në bazë të nenit 7, paragrafi 1, nën paragrafi 1.25 Ligjit Nr. 06/L - 056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, nenit 12, paragrafi 5 të Ligjit Nr.06/L - 057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe nenit 12 të Rregullores Nr.05/2019 për Procedurën Disiplinore të Prokurorëve, nxjerr vendim me numër KPK/Nr.256/2023, për themelimin e panelit hetimor për hetimin e rastit disiplinor AD.nr.03/2023, ndaj prokurores Ervehe Gashi, Prokuroria Themelore në Prizren - Departamenti i Krimeve të Rënda, për sigurimin e fakteve dhe mbledhjen e provave lidhur me shkeljen e supozuar disiplinore.

Paneli hetimor me qëllim të vërtetimit të plotë të fakteve dhe provave gjatë trajtimit të rastit disiplinor ndaj prokurores Ervehe Gashi, lidhur me lëndën [REDAKTUAR] /2019, ka vërtetuar pretendimet e paraqitura në kërkesën e autoritetit kompetent për iniciimin e procedurës disiplinore. Subjekti i hetimit disiplinor më datë 14.10.2019, nga stacioni policor në Prizren, ka pranuar kallëzimin penal. Më datë 17.12.2021, ka ngritur aktakuzën [REDAKTUAR] /2019, të përmirësuar dhe precizuar më datë 23.02.2022 ndaj zyrtarëve të lartë të Komunës së Prizrenit, për shkak të veprës penale "Keqpërdorim i pozitës apo autoriteti zyrtar" nga neni 422, paragrafi 2, pika 2.1 dhe 2.2, lidhur me paragrafin 1, neni 31 të KPRK - së."

Gjykata Themelore në Prizren, Departamenti për Krime të Rënda, në çështjen penale [REDAKTUAR] /21, lidhur me aktakuzën [REDAKTUAR] /2019, më datë 08.07.2022, nxjerr aktvendim me të cilin ka vendosur lidhur me kundërshtimin e provave nga ana e të pandehurve, ku disa kundërshtime i ka aprovuar, ndërsa disa të tjera i ka refuzuar. Palët kanë paraqitur ankesë ndaj aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prizren në Gjykatën e Apelit. Gjykata e Apelit, më datë 29.08.2022, ka nxjerrë aktvendim [REDAKTUAR] /2022, me të cilin e ka aprovuar ankesën e të pandehurve, ka ndryshuar aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prizren dhe ka hedhur aktakuzën e Prokurorisë Themelore në Prizren [REDAKTUAR] /2019, të datës 17.12.2021, e precizuar dhe e përmirësuar më datë 23.02.2022 dhe ka pushuar procedurën penale për shkak se aktakuza është ngritur jashtë afatit ligjor.

Subjekti i hetimit disiplinor më datë 06.01.2023, ka parashtruar propozim për paraqitje të kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë kundër aktvendimit të formës së prerë të Gjykatës

së Apelit [REDACTED]/2022, të datës 29.08.2022, në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit. Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, më datë 13.01.2023, ka konstatuar se nuk ka bazë ligjore për të ngritur kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë.

Subjekti i hetimit disiplinor në seancën dëgjimore e ka pranuar fajësinë dhe i njëjti thekson se: "Është shumë e vërtetë që këtë afat e kam huq, nuk e kam vërejtur, se (41) katërdhjetë e një faqe aktakuzë nuk i kisha ngritë kurrë edhe gjithë atë punë time me qu poshtë. E kam pas unë at mendim se veprimet hetimore duhet mi ndërmarrë në kuadër të (2) dy viteve, nuk guxoj me ndërmarrë ndonjë veprim mbas këtij afati. Po edhe kjo nuk ka qenë arsyeja që unë e kam ngritë akuzën mbas afati. Për këtë akuzë unë kam punu (3) tre muaj ditë, tre (3) muaj ditë derisa e kam përgatitë akuzën. Kjo, është një neglizhencë, nuk e di, nuk e di, për besë më ka ik, që ku jam, jam e gatshme edhe...me lidh marrëveshje...unë i kam lonë (3) tre muajt e fundit me hartu aktakuzën. Unë sa e di, është hera e parë, është hera e parë. Jo, i kam pas edhe dy aktakuza që i kam ngritë, po kam kërku zgjatje të hetimit, ama këtu unë ta kisha ditë që pe huqi afatin... o bre më ka dal prej mendëve krejt, nuk e kam këqyrë. O bre kisha kërku edhe (1) një muaj ditë barem për përpilim të aktakuzës mos kurgjë. (108) njëqind e tetë ditë kanë qenë, nuk i kam llogaritë shqyrtimet fillestare, shqyrtimet e dyta, nuk i kam llogaritë paraburgimet edhe seancat e marrëveshjes për pranim të fajësisë. Edhe problemi që na u ndërpre lidhja e marrëveshjeve për pranimin e fajësisë në atë kohë, kogja na e ka rëndu punën. Viti - 2021 (157) njëqind e pesëdhjetë e shtatë seanca, 2020 - njëqind e tetë (108) seanca, që i bjen brenda (650) gjashtëqind e pesëdhjetë dite, ma tepër se gjysma e ditëve në seanca, e ku është hetimi, e ku është përpilimi i aktakuzës. Qëndron kjo, qëndron kjo se unë nuk e kam vërejtë, nuk e kam vërejtë. Për (3) tre ditë nuk e kisha huq afatin, për tre ditë, se kisha huq kurr, ose s'isha lodh bre, s'isha lodh bre (40) katërdhjetë faqe aktakuzë mi bo kurr, kurr s'isha lodh. E kisha huq afatin edhe kisha shku i kisha thon shefit, shef ... në këtë rast unë e kam huq, se kam vërejtë, por na raste të tilla nuk kemi pas edhe se kemi diskutu. Shumë me vëmendje e kam shiqu edhe emailin për (2) dy vitet e fundit. Ka ndodh, tash çka ka ndodh unë kam qef mu kthy ajo kohë, po...".

Paneli hetimor, për lëndën AD.nr.03/2023, më datë 28 prill 2023, i ka paraqitur Këshillit Prokurorial të Kosovës marrëveshjen vullnetare për shkeljen e supozuar disiplinore në mes panelit hetimor dhe prokurores Ervehe Gashi.

Këshilli Prokurorial i Kosovës, më datë 23 maj 2023, pas shqyrtimit dhe analizimit të marrëveshjes vullnetare për shkeljen e supozuar disiplinore, të arritur në mes prokurores Ervehe Gashi dhe panelit hetimor, gjeti se marrëveshja vullnetare për pranim të përgjegjësisë disiplinore është e mbështetur edhe në provat material të lëndës penale [REDACTED]/2019, ku janë bërë lëshimet procedurale për rastin.

Këshilli Prokurorial i Kosovës, pajtohet me të gjeturat dhe sanksionin disiplinor të përcaktuar në nenin 7, paragrafi 1, pika 1.2 të Ligjit Nr. 06/L - 057 për Përgjegjësinë

Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, të propozuar nga autoriteti kompetent. Me marrëveshjen vullnetare për shkeljen e supozuar disiplinore të pranuar nga prokurorja Ervehe Gashi, është vërtetuar se është kryer shkelja disiplinore e përcaktuar në nenin 6, paragrafi 1, pika 1.3 dhe paragrafi 2, pika 2.1 të Ligjit Nr. 06/L - 057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Nga sa u tha më lartë, Këshilli Prokurorial i Kosovës në bazë të vlerësimit të çështjes morri vendim si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese brenda 15 ditëve, pas pranimit të vendimit drejtpërdrejtë në Gjykatën Supreme të Kosovës.

Jetish Maloku
Kryesues i Këshillit Prokurorial të Kosovës



T'u dërgohet:

- Z. Admir Shala, Kryeprokuror i Prokurorisë Themelore në Prizren
- Znj. Ervehe Gashi, Prokurore në Prokurorin Themelore në Prizren
- Arkivit të KPK-së